

Përmbledhje

Sistemi financiar në vend vazhdoi të shënoj rritje edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2018. Megjithatë, analiza krahasimore tremujore sugjeron një zvogëlim të aseteve të sistemit financiar në TM1 2018, kryesisht si pasojë e zvogëlimit të aseteve të sektorit bankar dhe atij pensional.

Sektori bankar në TM1 2018 është karakterizuar me rritje të aktivitetit kreditues, performancë të mirë financiare si dhe nivel të kënaqshëm të indikatorëve që matin shëndetin e sektorit. Në TM1 2018, asetet e sektorit bankar u zvogëluar për 4.6 milionë euro, kryesisht rezultat i tkurrjes së kategorisë së parashë gatshme dhe bilancit të mbajtur në BQK, si dhe kategorisë së investimeve të mbajtura në bankat tjera. Rritja e gjithsej stokut të kredive, ndër tjerash erdhi edhe si rezultat i rritjes së kredive të reja gjatë kësaj periudhe, veçanërisht kredive me karakter investues (ndërmarrje) dhe atyre për konsum (ekonomi familjare). Sektorët ekonomik që u kredituan më shumë në këtë periudhë ishin tregtia, bujqësia dhe prodhimtaria.

Rritja e kreditimit vazhdon të financohet kryesisht nga depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së vendit, të cilat në fund të TM1 2018 përfaqësuan 79.4 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit. Në TM1 2018, depozitat u zvogëluar për 18.3 milionë euro, kryesisht si pasojë e tkurrjes së depozitave të ndërmarrjeve të mbajtura në sektorin bankar gjatë kësaj periudhe.

Në TM1 2018, normat e interesit në kredi kanë vazhduar trendin rënës, kurse ato në depozita kanë shënuar një rritje të lehtë vjetore. Norma e interesit në kredi në TM1 2018 qëndroi në nivel prej 6.9 përqind, kurse në depozita në 1.1 përqind.

Sektori bankar u karakterizua me performancë të kënaqshme financiare gjatë TM1 2018, duke realizuar fitim neto prej 17.9 milionë euro, por që është më i ulët krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Rënia e lehtë e profitit të realizuar, ishte kryesisht pasojë e rritjes së shpenzimeve, përderisa të hyrat mbetën në nivel të ngjashëm me periudhën e kaluar.

Sektori bankar shënoi përmirësim të indikatorëve kyç të shëndetit financiar. Në TM1 2018, niveli i kredive jo performuese qëndroi në nivel prej 2.9 përqind kurse mbulueshmëria e tyre me provizione në nivel prej 155.1 përqind. Në të njëjtën periudhë, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit qëndroi në nivel prej 18.3 përqind, përderisa sektori gëzoi edhe nivel të kënaqshëm të likuiditetit prej 35.9 përqind.

Në TM1 2018, sektori pensional shënoi rënie të aseteve, megjithëse stoku i gjithsej aseteve të sektorit shënoi rritje që u reflektua edhe në rritjen e peshës së sektorit në asetet e sistemit financiar krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Në tremujorin e parë, ky sektor u karakterizua me ecuri pozitive të kontributeve të reja, ndërsa performancë negative sa i përket kthimit bruto nga investimet.

Sektori i sigurimeve mbylli këtë tremujor me rezultat pozitiv financiar, megjithëse në vlerë më të ulët krahas tremujorit të njëjtë në vitin paraprak. Më saktësisht, faktorët që ndikuan në dinamikat e sektorit të sigurimeve ishin rritja në të hyrat neto nga primet dhe menaxhimi efikas i shpenzimeve të sektorit, ndërsa faktorët të cilët kontribuan negativisht ishin zvogëlimi i aseteve dhe rritja e theksuar e dëmeve të ndodhura gjatë TM1 2018.

Sektori mikrofinanciar ka vazhduar të rrisë aktivitetin, ku edhe tremujori i parë u karakterizua me rritje të theksuar të aseteve si rezultat i rritjes së stokut të kredive të këtij sektori. Njëkohësisht, dinamikat në këtë sektor dhe rritja e konsiderueshme e të hyrave rezultuan në rritje të profitit gjatë tremujorit të parë të vitit 2018.

Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës gjatë këtij tremujori u karakterizua me rritje të vlerës së emetuar dhe rritje të afatit të maturimit, por kërkesë më të ulët për të investuar në letrat me vlerë, gjë që mund të ketë ndikuar në rritjen e normës së përgjithshme të interesit në TM1 2018.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE-----i

Sistemi Financiar-----	05
Sektori Bankar-----	05
Sektori Pensional-----	13
Sektori i Sigurimeve-----	14
Sektori Mikrofinanciar-----	16
Tregu i Letrave me Vlerë-----	20

GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës-----	05
Figura 2. Ndryshimi tremujor i asetëve të sektorëve përbërës të sistemit financiar-----	05
Figura 3. Ndryshimi tremujor në strukturën e asetëve të sektorit bankar-----	06
Figura 4. Ndryshimi tremujor në vlerën e gjithsej kredive dhe kategorive kryesore-----	06
Figura 5. Ndryshimi tremujor në strukturën e kredive sipas veprimtarisë ekonomike-----	07
Figura 6. Ndryshimi tremujor në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake-----	07
Figura 7. Ndryshimi tremujor në vlerën e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore-----	08
Figura 8. Ndryshimi tremujor në strukturën e depozitave-----	08
Figura 9. Norma e interesit në kredi dhe depozita-----	08
Figura 10. Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare-----	09
Figura 11. Norma e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik-----	09
Figura 12. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare-----	09
Figura 13. Norma e interesit në depozitat-----	10
Figura 14. Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve-----	10
Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare-----	11
Figura 16. Profiti neto i sektorit bankar-----	11
Figura 17. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar-----	11
Figura 18. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar-----	12
Figura 19. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve-----	12
Figura 20. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës-----	13
Figura 21. Asetet e sektorit pensional-----	13
Figura 22. Struktura e asetëve të FKPK-së-----	13
Figura 23. Struktura e asetëve të FSKP-së-----	14
Figura 24. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së-----	14

Figura 25. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	15
Figura 26. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	15
Figura 27. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	16
Figura 28. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve-----	17
Figura 29. Vlera e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik-----	17
Figura 30. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar -----	18
Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	18
Figura 32. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik-----	18
Figura 33. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar-----	19
Figura 34. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	19
Figura 35. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	19
Figura 36. Shuma e borxhit të emetuar -----	20
Figura 37. Shuma e kërkuar dhe e emetuar -----	20
Figura 38. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	20
Tabela 1. Numri dhe shuma e letrave me vlerë të arkëtuara nga Qeveria e Kosovës-----	20
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	23


SHKURTESAT:

APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CHF	Franku Zvicërran
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik
IHD	Investimet Huaja Direkte
KJP	Kreditë Jopërfomuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
USD	Dollari Amerikan
WEO	World Economic Outlook

Sistemi Financiar

Sistemi financiar vazhdon të shënoj rritje, kryesisht si rezultat i zgjerimit të sektorit bankar dhe atij pensional. Sektori i sigurimeve dhe ai mikrofinanciar kishin kontribut pozitiv por të ulët në zgjerimin e aseteve të sistemit.


Figura 1. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK (2018)

Vlera e gjithsej aseteve të sistemit financiar në fund të TM1 2018 arriti në 5.91 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 7.2 përqind (figura 1).

Figura 2. Ndryshimi tremujor i aseteve të sektorëve përbërës të sistemit financiar



Burimi: BQK (2018)

Ndërkaq, në baza tremujore, asetet e sistemit financiar shënuan rënie për 11.3 milionë euro në TM1 2018 kundrejt tremujorit të njëjtë të vitit paraprak,

kryesisht si pasojë e zvogëlimit të aseteve të sektorit bankar si dhe sektorit pensional.

Sektori Bankar

Sektori bankar në TM1 2018 u karakterizua me rritje më të ngadalësuar të aktivitetit kreditues dhe performancë të mirë financiare, edhe pse më të ulët kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Bankat vazhduan të kenë nivel të kënaqshëm të indikatorëve që matin shëndetin e sektorit.


Asetet

Asetet e sektorit bankar në TM1 2018 u zvogëluan për 4.6 milionë euro, duke arritur vlerën prej 3.87 miliardë euro në fund të periudhës. Zvogëlimi i aseteve të sektorit bankar kryesisht i atribuohet zvogëlimit të kategorisë së parasë së gatshme dhe bilancit të mbajtur në BQK, pasuar nga kategoria e mjeteve të mbajtura në bankat tjera. Investimet në letrat me vlerë për të tretin vit me radhë shënuan rënie. Kurse, vlera e kredive të lëshuara nga sektori bankar, që njëherësh ka edhe pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej asetet e sektorit prej 65.4 përqind, ishte kategoria e vetme që shënoi rritje në TM1 2018 (figura 3).

Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në u zvogëluan për 21.2 milionë euro në TM1 2018, dhe shënuan vlerën prej 478.1 milionë euro në fund të periudhës së cekur. Ky zvogëlim i aseteve të kësaj kategorie kryesisht reflekton nivelin e parasë së gatshme të mbajtur në trezor të bankave, që u zvogëlua për 21.1 milionë euro. Ky zhvillim mund të jetë pasojë e

zvogëlimit të stokut të depozitave në TM1 2018, në prani të rritjes më të theksuar të kredive të reja gjatë kësaj periudhe krahasuar me rritjen e depozitave të reja.

Figura 3. Ndryshimi tremujor në strukturën e aseteve të sektorit bankar



Burimi: BQK (2018)


Në TM1 2018, stoku i letrave me vlerë të sektorit bankar u zvogëlua për 10.0 milionë euro (zvogëlim për 19.0 milionë euro në TM1 2017) dhe shënoi vlerën në 476.8 milionë euro në fund të periudhës së cekur. Rënia e investimeve në letrat me vlerë reflekton trendin e përgjithshëm në kuadër të aseteve të sektorit bankar në TM1 2018. Për më shumë, zvogëlimi i investimeve në letra me vlerë mund t'i atribuohet edhe fokusimit të investimeve të bankave drejt aktivitetit kreditues, si instrument më profitabil. Normat e ulëta të kthimit në letra me vlerë mund të kenë rezultuar në zhvendosjen e fokusit të bankave prej investimeve në tregun e letrave me vlerë drejt aktivitetit kreditues.

Kreditë

Kreditë e lëshuara nga sektori bankar shënuan rritje edhe në TM1 2018, rritje e cila ishte më e ngadalësuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Sektori bankar kreditoi ekonominë vendore në vlerë prej 48.9 milionë euro në TM1 2018, duke arritur vlerën në 2.53 miliardë euro në fund të periudhës së cekur (figura 4). Ndikim në rritjen e kredive aktive kishin kreditë e reja të lëshuara si për ndërmarrjet (të cilat shënuan vlerën prej 174.7 milionë euro në TM1 2018) ashtu edhe për ekonomitë familjare (të cilat shënuan vlerën prej 138.9 milionë euro). Ecuria në stokun e gjithsej kredive aktive dhe atyre të reja, ndër tjerash, u ndikuan nga oferta lehtësuese e aplikuar nga bankat përmes përmirësimit të kushteve të kreditimit për të dy kategoritë ekonomike.

Figura 4. Ndryshimi tremujor në vlerën e gjithsej kredive dhe kategorive kryesore




Burimi: BQK (2018)

Kreditë ndaj ndërmarrjeve në TM1 2018 u rritën për 29.5 milionë euro dhe arritën vlerën prej 1.61 miliardë euro në fund të periudhës (figura 4). Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i tregtisë dhe ai i bujqësisë shënuan rritjen më të lartë, pasuar nga sektori i prodhimitarisë (figura 5). Kreditë për sektorin e tregtisë, të cilat dominojnë strukturën e gjithsej kredive të ndërmarrjeve, shënuan rritje për 16.3 milionë euro në TM1 2018 dhe arritën vlerën prej 802.1 milionë euro në fund të periudhës së cekur. Në anën tjetër, kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë ndërpreu trendin rënës të katër viteve të fundit dhe u

karakterizua me rritje prej 8.3 milionë euro në TM1 2018, duke arritur vlerën e stokut prej 63.8 milionë euro. Kreditë ndaj sektorit të prodhimtarisë vazhduan të karakterizohen me rritje edhe në TM1 2018 (4.6 milionë euro), ku vlera e stokut arriti në 192.7 milionë euro.

Figura 5. Ndryshimi tremujor në strukturën e kredive sipas veprimtarisë ekonomike



Kreditë ndaj ekonomive familjare në TM1 2018 u rritën për 19.6 milionë euro dhe arritën vlerën e stokut të kredive prej 917.2 milionë euro. Kjo rritje ndër tjerash reflekton ecurinë në kreditë e reja të lëshuara nga bankat gjatë kësaj periudhe. Më konkretisht, gjatë kësaj periudhe, vlera e kredive të reja të destinuara për konsum arriti vlerën në 106.0 milionë euro, apo 36.3 milionë euro më shumë se sa vlera në TM1 2017.


Kurse, kreditë e reja hipotekare të lëshuara nga bankat arrit vlerën në 23.1 milionë euro, apo 1.5 milionë euro më shumë se sa vlera në TM1 2017.

Detyrimet dhe Burimet Vetanake

Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit bankar dominohet nga depozitat, të cilat

përbëjnë 79.4 përqind të gjithëj detyrimeve. Në TM1 2018 është shënuar një rënie e vlerës së gjithëj depozitave krahasuar me rritjen e shënuar në TM1 2017. Kategoria e dytë më e rëndësishme, ajo e burimeve vetanake, kryesisht si rezultat i rritjes së fitimit të realizuar, u karakterizua me rritje prej 18.3 milionë euro në TM1 2018. Kategoritë tjera nuk pësuan ndryshime të dukshme në kuadër të strukturës së gjithëj detyrimeve dhe burimeve vetanake në TM1 2018 (figura 6).


Figura 6. Ndryshimi tremujor në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake



Depozitat


Depozitat në sektorin bankar të Kosovës u zvogëluan për 18.3 milionë euro në TM1 2018 në baza tremujore, dhe shënuan vlerën prej 3.07 miliardë euro. Dinamikat që karakterizuan depozitat e sektorit bankar në TM1 2018 kryesisht i atribuohen zhvillimeve në kuadër të depozitave për ndërmarrjet, të cilat u zvogëluan për 72.8 milionë euro dhe shënuan vlerën prej 689.0 milionë euro në fund të periudhës së cekur.

Figura 7. Ndryshimi tremujor në vlerën e gjithsej deponitave dhe kategorive kryesore



Në anën tjetër, deponizat për ekonomitë familjare u rritën për 52.4 milionë euro në TM1 2018 dhe arritën vlerën prej 2.22 miliardë euro në fund të periudhës (figura 7).

Figura 8. Ndryshimi tremujor në strukturën e deponitave




Rritja e deponitave të ekonomive familjare në këtë tremujor mund t'i atribuohet deri në një masë rritjes së burimeve të të hyrave në ekonomi gjatë këtij tremujori, si dhe rritjes së lehtë të normave të interesit në deponiza. Në anën tjetër, pavarësisht rritjes së normës së interesit në deponizat e ndërmarrjeve, vlera e deponitave të ndërmarrjeve shënoi rënie në TM1 2018, rënie që mund t'i atribuohet deri në një masë rritjes së aktivitetit ekonomik gjatë kësaj periudhe (figura 7).

Sipas kategorive të deponitave, deponizat e transferueshme u zvogëluan për 33.7 milionë euro në TM1 2018 në baza tremujore, dhe shënuan vlerën prej 1.83 miliardë euro në fund të periudhës së cekur. Në anën tjetër, deponizat e afatizuara shënuan rritje për 14.4 milionë euro në këtë tremujor dhe arritën vlerën prej 763.4 milionë euro në fund të periudhës. Po ashtu, edhe deponizat e kursimit rritje tremujore për 2.7 milionë euro kundrejt zvogëlimit prej 5.9 milionë euro në TM1 2017, dhe arritën vlerën në 481.3 milionë euro në fund të periudhës së cekur (figura 8). Normat e interesit në deponizat e afatizuara dhe deponizat e kursimit mund të ketë ndikuar në rritjen e këtyre kategorive të deponitave.

Normat e Interesit¹

Në TM1 2018, normat e interesit në kredi kanë vazhduar trendin rënës, kurse ato në deponiza kanë shënuar një rritje të lehtë vjetore. Dallimi në mes të normës të interesit në kredi dhe asaj në deponiza u ngushtua në 5.8 pikë përqindje (6.3 pikë përqindje në TM1 2017).

Figura 9. Norma e interesit në kredi dhe deponiza



¹ Kalkulimi i normave të interesit: mesatarja tremujore e normave të interesit në kredi, gjeçjesisht në deponiza. Në tekst ju referohemi si 'normë e interesit'.


Norma e interesit në kredi në TM1 2018 u zvogëlua në 6.9 përqind përderisa norma e interesit në depozita shënoi rritje të lehtë në 1.1 përqind kundrejt TM1 2017 (figura 9).

Normat e interesit në kredi

Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve zbriti në 6.6 përqind, nga 6.9 përqind sa ishte në TM1 2017 (figura 10).

Të gjitha kategoritë e normave të interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në TM1 2018 shënuan rënie vjetore. Rënia më e madhe (0.4 pikë përqindje) u shënuar tek kreditë për qëllime investuese, duke zbritur në 6.6 përqind. Në periudhën raportuese, normat e interesit në kreditë për qëllime jo-investuese bartën normë të interesit prej 6.8 përqind. Kategoritë tjera të normave të interesit të aplikuara për ndërmarrjet siç janë linjat kreditore dhe ato me kushte favorizuese gjithashtu shënuan rënie gjatë kësaj periudhe. Këto kategori vazhdojnë të bartin norma mjaft të ulëta të interesit (2.6 përqind në TM1 2018), por të cilat janë të mbuluara me para të gatshme dhe asete tjera likuide.


Figura 10. Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare



Burimi: BQK (2018)

Normat e interesit në kreditë ndaj të gjithë sektorëve ekonomik vazhduan të shënojnë rënie, por me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me vitin 2014 dhe 2015. Në TM1 2018, normën më të ulët të interesit në kredi shënoi sektori i industrisë dhe ai i shërbimeve, përderisa normën më të lartë të interesit e bartë sektori i bujqësisë (figura 11).

Figura 11. Norma e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2018)

Normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare ndoqën trendin e përgjithshëm të normave të interesit të aplikuara nga bankat.

Normat e interesit të aplikuara për kreditë hipotekare vazhdojnë të jenë më të favorshme, duke qenë se kreditë e destinuar për këtë kategori të ekonomive familjare janë të siguruara me patundshmëri. Në TM1 2018, norma e interesit e aplikuar për kreditë hipotekare qëndroi në 6.0 përqind, një rënie prej 0.2 pikë përqindje krahasuar me TM1 2017. Normat e interesit të aplikuara për kredit konsumuese janë dukshëm më të larta dhe qëndrojnë mesatarisht në 7.6 përqind, megjithëse janë karakterizuar me rënie vjetore prej 0.6 pikë përqindje. Pavarësisht rënies së përgjithshme të normave të interesit si në kreditë ndaj ekonomive familjare ashtu edhe në kreditë për


ndërmarrjet, bankat vazhdojnë të aplikojnë norma të larta të interesit për kategorinë e mbitërheqjeve. Kjo kategori në TM1 2018 kishte normë të interesit prej 16.2 përqind, që njëherësh përbën edhe një rritje vjetore prej 4.0 pikë përqindje (figura 12).



Burimi: BQK (2018)

Normat e interesit në depozita

Normat e interesit në depozita, pavarësisht rritjes së lehtë në vitin e fundit, vazhdojnë të jenë në nivele mjaftë të ulëta krahasuar me periudhat para vitit 2014 (figura 13).




Burimi: BQK (2018)

Normat e interesit në depozitat për ndërmarrjet

vazhdojnë të jenë më të favorshme krahasuar me normat që ofrohen për ekonomitë familjare.

Në depozitat e ndërmarrjeve, norma e interesit qëndroi në nivel prej 1.5 përqind në TM1 2018, një rritje për 0.2 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e parë të vitit paraparak. Më konkretisht, rritje shënuan normat e interesit në depozitat e afatizuara (1.5 përqind në TM1 2018 nga 1.2 përqind në TM1 2017). Normat e interesit në depozitat e kursimit të ndërmarrjeve shënuan ngritje të lehtë kurse ato të transferueshme mbetën në nivele të ngjashme me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (figura 14).

Figura 14. Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve, sipas kategorive




Burimi: BQK (2018)

Normat e interesit në depozitat e ekonomive familjare qëndruan në 1.1 përqind në TM1 2018, (figura 15).

Pra, norma e interesit në depozitat e transferueshme (0.001 përqind), të kursimit (0.3 përqind) dhe ato të afatizuara (1.1 përqind) në TM1 2018 janë të ngjashme me normat e aplikuar në TM1 2017, dhe pothuajse të pandryshueshme nga tre vitet e fundit.

Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive




Burimi: BQK (2018)

Performanca e sektorit bankar

Vlera e profitit të realizuar në TM1 2018 arriti në 17.9 milionë euro, për 3.5 milionë euro më e ulët krahasuar me tremujorin e parë të vitit paraprak (figura 16). Rënia e lehtë e profitit të realizuar ishte kryesisht rezultat i rritjes së shpenzimeve, përdërisa të hyrat mbetën në nivel të ngjashëm me periudhën e kaluar.

Figura 16. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro




Burimi: BQK (2018)

Të hyrat e sektorit bankar në TM1 2018 u karakterizuan me rënie të lehtë, kryesisht rezultat i zvogëlimit të hyrave nga jo-interesi dhe atyre nga

rivlerësimi. Kurse, kategoria kryesore e të hyrave, ato nga interesi u karakterizuan me rritje gjatë kësaj periudhe. Në TM1 2018, vlera e të hyrave arriti në 57.6 milionë euro, që paraqet një rënie për 0.6 milionë euro krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 17).

Figura 17. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar



Burimi: BQK (2018)


Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar në TM1 2018 arriti në 39.7 milionë euro, një rritje prej 2.9 milionë euro kundrejt tremujorit të parë të vitit paraprak (figura 17).

Rritja e shpenzimeve të sektorit bankar kryesisht i atribuohet rritjes së shpenzimeve të jo-interesit dhe shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, që u rritën për 1.1 milionë euro secila kategori. Në kuadër të shpenzimeve të jo-interesit, ndikimin më të lartë në rritjen e tyre e kishin nënkategoritë e provizioneve të ndara për humbjet e mundshme në kredi. Kjo nënkategori u rrit për 0.6 milionë euro krahasuar me TM1 2017, në 3.5 milionë euro. Në kuadër të shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, në TM1 2018 është shënuar rritje për secilën nga nënkategoritë përbërëse (të personelit, të përgjithshme, dhe të tjera). Shpenzimet e interesit në

TM1 2018 mbetën në nivel të ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kryesisht si rezultat i ndryshimit simbolik të normave të interesit në depozitat e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit shënoi rritje në TM1 2018 për 5.7 pikë përqindje, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke qëndruar në 68.9 përqind. Kjo erdhi si rezultat i rënies së përgjithshme të hyrave në një periudhë të rritjes së shpenzimeve (figura 17).

Figura 18. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Shënim: Në kalkulim të KMA dhe KMK profiti për tremujorin përkatës është analizuar Burimi: BQK (2018)


Performanca financiare e sektorit bankar në këtë tremujor u reflektua edhe në dy indikatorët e profitabilitetit, kthimin në mesataren e aseteve (KMA) edhe kthimin në mesataren e kapitalit (KMK). KMA u zvogëluar për 0.4 pikë përqindje në 2.1 përqind, përderisa KMK u zvogëluar për 4.3 pikë përqindje në 16.6 përqind në TM1 2018 (figura 18).

Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2018 është karakterizuar me rënie të nivelit të kredive joperformuese dhe përmirësim të mbulueshmërisë së tyre me provizione. Niveli i

kredive joperformuese në fund të TM1 2018 qëndroi në 2.9 përqind, që paraqet një rënie prej 1.6 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 19).

Figura 19. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë dhe norma e rritjes së KJP-ve




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur Burimi: BQK (2018)

Niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione u përmirësua edhe më tej duke i mbuluar rreth 55 përqind më shume se sa niveli i kërkuar me rregullore, kryesisht si rrjedhojë e rënies së theksuar të vlerës së kredive joperformuese në periudhën raportuese.

Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ka qëndruar në nivel të ngjashëm me vitin paraprak prej 18.3 përqind. Niveli i kapitalizimit të sektorit bankar vazhdon të jetë dukshëm mbi nivelin minimal të kërkuar me rregullore prej 12.0 përqind.

Treguesi kyç i likuiditetit, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra, shënoi rënie në fund të TM1 2018 krahasuar me TM1 2017. Ky indikator qëndroi në nivel prej 35.9 përqind, një rënie për 2.8 pikë përqindje krahasuar me TM1 2018. Rënia e këtij treguesi i atribuohet rritjes së kredive, gjë që rezultoi në zvogëlim të aseteve likuide, si dhe rritjes së detyrimeve afatshkurtra (figura 20).

Figura 20. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK (2018)

Sektori pensional

Ecuri pozitive në sektor ishte rritja e kontributeve të reja të arkëtuara, përderisa sektori kishte performancë negative nga investimet si pasojë e luhatjeve negative në tregjet financiare në fund të TM1 2018.

Figura 21. Asetet e sektorit pensional




Burimi: BQK (2018)

Sektori pensional vazhdon të jetë sektori i dytë për nga pjesëmarrja në asetet e sistemit financiar me 27.8 përqind të gjithsej aseteve, ku stoku i aseteve të këtij

sektori deri në mars 2018 shënoi rritje vjetore prej 9.2 përqind.

Megjithatë, në TM1 2018, asetet e menaxhuara nga sektori pensional ndërruan kahje dhe shënuan rënie për 13.1 milionë euro kundrejt TM1 2017, (figura 21). Kjo rënie u ndikua nga investimi më i vogël i aseteve jashtë vendit gjatë këtij tremujori, komponentë që përbën pjesën më të madhe të aseteve të fondeve. Më saktësisht, FKPK si përfaqësuese e rreth 99.5 përqind të gjithsej aseteve të fondit pensional, uli investimet në fondet e përbashkëta për 2.2 përqind në krahasim me tremujorin paraprak. Ndërsa, në të njëjtën periudhë, investimi në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës u rrit për 28.8 përqind krahas tremujorit paraprak.

Figura 22. Struktura e aseteve të FKPK-së (TM1 2018)




Burimi: FKPK (2018)

Fondet pensionale që operojnë në Kosovë kanë strategji të ndryshme të investimit të aseteve të tyre. FKPK ndjekë një strategji të kujdesshme të investimit, duke siguruar diversifikim të rrezikut në fonde të përbashkëta investuese që menaxhohen nga ndërmarrjet për menaxhim të mjeteve. Në anën tjetër, FSKP investon asetet e tyre kryesisht në aksione

jashtë vendit, pasuar nga asetet e investuara në obligacione si në Kosovë ashtu edhe jashtë vendit (figura 22 dhe 23).

Figura 23. Struktura e aseteve të FSKP-së (TM1 2018)




Burimi: FSKP (2018)

Arkëtimet e reja gjatë tremujorit të parë të vitit 2018 u shtuan për 3.0 milionë euro (8.0 përqind) krahas tremujorit të njëjtë të vitit paraprak dhe arritën në 40.8 milionë euro. Nga këto kontribute të arkëtuara, rreth 99 përqind i takojnë FKPK-së dhe pjesa e mbetur FSKP-së. Rritja e arkëtimeve u ndikua deri në një masë nga numri më i madh i kontribuuesve të rinj në këtë tremujor në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Gjithashtu, vlера e arkëtimeve të reja mund të jetë ndikuar deri në një masë edhe nga rritja e të ardhurave të të punësuarve në sektorin publik², si sektor dominues në tregun e punës.

Në këtë tremujor FKPK kishte performancë negative nga investimet ku vlerësimi i aseteve të investuara u zvogëlua duke rezultuar në një kthim bruto prej -32.6 milionë euro krahas kthimit bruto prej 46.7 milionë të tremujorit të parë paraprak (figura 24). Ndërsa, FSKP pati një ngadalësim të kthimit bruto nga

investimet duke zbritur në 107.9 mijë euro nga 268.0 mijë euro në TM1 2017.

Figura 24. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK (2018)

Edhe pse në fillim të tremujorit tregjet financiare në SHBA u karakterizuan me ecuri pozitive dhe përmirësim të treguesve makroekonomik, rritja e normës bazë të interesit nga Rezerva Federale e SHBA-ve për 0.25 përqind ndikoi në luhatje të rritura në tregjet financiare që mbyllën këtë tremujor me performancë negative. Zhvillimet negative të lartcekura u reflektuan në performancën e FKPK-së, duke marr parasysh portofolion e dominuar nga investimet në fondet e përbashkëta të SHBA-ve. Më të prekura nga këto lëvizje ishin fondet e përbashkëta investive, të koncentruara në investimin në aksione dhe sektorë specifik.³

Sektori i sigurimeve


Rritja në të hyrat neto nga primet dhe menaxhimi efikas i shpenzimeve rezultuan në rezultat pozitiv financiar të sektorit të sigurimeve, mirëpo rritja e dëmeve të ndodhura

² ASK, Buletini Tremujor, TM1 2018.

³ FKPK, Buletini Tremujor TM1 2018, Maj 2018

ndikoi që ky rezultat të jetë më i dobët se sa ai i tremujorit të njëjtë të vitit paraprak.

Figura 25. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK (2018)

Sektori i sigurimeve u karakterizua me zhvillime pozitive gjatë TM1 2018, duke gjeneruar rezultat pozitiv financiar, megjithë zvogëlimin e aseteve gjatë TM1 2018.

Asetet e sektorit të sigurimeve u ndikuan kryesisht nga rënia e mjeteve likuide, saktësisht nga rënia e parave të gatshme në BQK dhe depozitat në bankat komerciale, e që njëkohësisht përbëjnë edhe kategorinë me pjesëmarrjen më të madhe në gjithsej asetet e sektorit. Në TM1 2018, asetet rezultuan me vlerë negative prej 1.3 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 4.5 milionë euro kundrejt TM1 2017 (figura 25).


Ecuria e gjithsej aseteve të sektorit reflekton zhvillimet në sektorin e sigurimeve 'jetë', asetet e të cilave u zvogëluar për 4.1 milionë në TM1 2018 krahas TM1 2017. Ndikim në rënien e aseteve të sektorit, mirëpo deri në një masë më të lehtë kishte edhe rënia e aseteve të sigurimeve jo-jetë prej 355.6 mijë euro.

Vlera e primeve të shkruara nga kompanitë e sigurimeve gjatë TM1 2018 arriti vlerën prej 21.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.3 përqind. Primet e sigurimit jo-jetë përfaqësojnë 96.7 përqind të gjithsej strukturës së primeve të shkruara. Vlera e primeve të shkruara nga sigurimi jo-jetë arriti në 20.5 milionë euro në TM1 2018 (9.3 përqind rritje vjetore). Vlera e primeve të shkruara nga sigurimi 'jetë' gjithashtu u karakterizua me rritje vjetore, prej 10.1 përqind duke arritur në 706.5 mijë euro.

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), zbritën në 12.1 milionë euro në TM1 2018 (12.2 milionë euro në TM1 2017), që paraqet një rënie të lehtë prej 0.5 përqind.

Pjesa e primeve të shkruara të sektorit e cila i dedikohet pagesës së dëmeve të ndodhura u ngushtua gjatë këtij tremujori për shkak të rënies së dëmeve të paguara dhe rritjes së primeve të pranuar gjatë kësaj periudhe. Ky përmirësim u reflektua përmes uljes së këtij raporti për 5.5 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në 57.2 përqind (figura 26).

Figura 26. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK (2018)

Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve gjatë tremujorit të këtij vitit u karakterizua me performancë pozitive mirëpo më të ulët në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak.

Të hyrat neto nga primet e sektorit të sigurimeve në TM1 2018 shënuan rritje vjetore prej 4.6 përqind, përderisa në të njëjtën periudhë, shpenzimet e sektorit të sigurimeve u karakterizuan me një rënie të theksuar vjetore prej 7.1 përqind. Përkundër, rritjes së të hyrave kundrejt rënies së shpenzimeve, rritja e dëmeve të ndodhura, prej 29.9 përqind, ndikoi që sektori i sigurimeve në TM1 2018 regjistrojë fitim prej 433.8 mijë euro, e që është fitim më i ulët se ai i TM1 2017 prej 912.1 mijë euro. Rënia e shpenzimeve të sektorit në periudhën raportuese mund t'i atribuohet deri në një masë hyrjes në fuqi të Rregullores për shitjen e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe menaxhimin e shpenzimeve të siguruesve.

Po ashtu, rezultati pozitiv financiar u ndikua edhe nga ndryshimi i legjislacionit sekondar të BQK-së në përputhje me kërkesat ligjore, në kuadër të Rregullores së Fondit të Kompensimit. Këto hapa kanë ndikuar në zvogëlimin e shpenzimeve dhe rrjedhimisht në realizimin e profitit.

Krahas zhvillimeve pozitive në sektor, pozicioni i likuiditetit u përmirësua gjithashtu gjatë TM1 2018 kur marrim për bazë stokun e aseteve deri në mars 2018. Ky përmirësim u ndikua si nga rritja vjetore e stokut të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj (4.9 përqind), ashtu edhe nga rënia e rezervave teknike (2.2 përqind), ku raporti në mes tyre arriti në

99.5 përqind nga 92.7 përqind në mars 2017. Tregues tjerë të likuiditetit po ashtu u përmirësuan, mbështetur kryesisht nga rritja më e madhe e stokut të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj kundrejt rritjes së gjithsej detyrimeve të sektorit. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve rezultoi të jetë në 87.3 përqind, nga 84.6 përqind në mars 2017.


Sektori mikrofinanciar

Rritja e aseteve, kryesisht e ndikuar nga rritja e konsiderueshme e stokut të kredive të këtij sektori, si dhe rritja e të hyrave rezultuan në performancën pozitive të këtij sektori gjatë këtij tremujori.

Asetet

Sektori mikrofinanciar ishte sektori me rritjen më të lartë të stokut të aseteve në kuadër të sistemit financiar deri në mars të vitit 2018. Edhe pse pesha e këtij sektori në gjithsej asetet e sistemit financiar u rrit, gjithsesi mbetet e ulët në rreth 3.5 përqind.

Figura 27. Asetet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2018)


Gjatë tremujorit të parë të vitit 2018, vlera e gjithsej asetëve të sektorit mikrofinanciar arriti në 10.4 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 11.6 përqind në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (figura 27).

Zgjerimi i sektorit mikrofinanciar kryesisht i atribuohet rritjes së aktivitetit kreditues, që u financua kryesisht nga huazimet në sektorin e jashtëm (68.0 përqind të gjithsej asetëve).

Kreditë

Vlera e stokut të kredive të institucioneve mikrofinanciare në TM1 2018 ishte 9.0 milionë euro, e cila është për 0.7 milionë euro më e vogël se vlera e stokut të kredive në TM1 2017 (figura 28).

Figura 28. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, rritja vjetore e kredive




Kreditë për ekonomitë familjare, që kanë një pjesëmarrje prej 64.5 përqind në gjithsej kreditë e sektorit, shënuan rritje prej 1.9 milionë euro kundrejt TM1 2017. Në anën tjetër, kreditë ndaj ndërmarrjeve, që përfaqësojnë 35.5 përqind të gjithsej kredive të sektorit, u zvogëluan për 2.5 milionë euro. Pavarësisht dinamikave tremujore, stoku i kredive të

lëshuara për ndërmarrjet shënoi rritje të theksuar vjetore.

Sa i përket kreditimit ndaj sektorëve ekonomik, nëse krahasojmë ecurinë e kreditimit të sektorëve ekonomik në tremujorët e fundit, kreditimi i pothuajse të gjithë sektorëve ekonomik u karakterizua me rënie, kjo duke marrë parasysh që gjithsej kreditimi ndaj ndërmarrjeve ishte më i ulët gjatë këtij tremujori. Sektori i vetëm për të cilin vlera e kredive u rrit ishte ai i bujqësisë, me 0.3 milionë euro më shumë nga tremujori i njëjtë i vitit paraprak (figura 29).

Figura 29. Vlera e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik




Lizingjet

Lizingjet gjatë tremujorit të parë të vitit 2018 arritën në 1.4 milionë euro, një rritje prej 1.2 milionë euro nga tremujori i njëjtë i vitit paraprak (figura 30).

Në rritjen e vlerës së lizingjeve gjatë këtij tremujori kontribuoi rritja e lizingjeve hipotekare kryesisht për ekonomitë familjare, pasuar nga kategoria e 'lizingjeve tjera' kryesisht për ndërmarrjet.

Figura 30. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2018)

Normat e Interesit

Normat mesatare të interesit në kredi ndërruan kahje për dallim nga viti paraprak, duke shënuar rritje në të dy kategoritë dhe po thuajse për të gjithë sektorët ekonomik, rritje e cila mund të jetë reflektim i rritjes së shpenzimeve operative të institucioneve mikrofinanciare.

Gjatë këtij tremujori, norma mesatare e interesit u rrit në 22.7 përqind, nga 22.2 përqind sa ishte mesatarja për TM1 2017.

Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2018)

Norma e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare u rrit për 0.4 pikë përqind, ndërsa norma e interesit për kreditë ndaj ndërmarrjeve u karakterizua me rritje prej 0.7 pikë përqind (figura 31). Në kuadër të ekonomive familjare norma mesatare e interesit në kreditë konsumuese u rrit për 0.2 pikë përqindje, ndërsa për kreditë hipotekare ajo u rrit për 0.8 pikë përqindje.

Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve rezulton të ketë normën më të ulët të interesit në kredi, e cila po ashtu ishte e vetmja kategori që shënoi rënie të normës mesatare të interesit kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak për 0.4 pikë përqind. Ndërsa, sektori i industrisë vazhdon të ketë normën më të lartë të interesit në kredi duke shënuar rritje të mëtutjeshme për 0.2 pikë përqind (figura 32).

Figura 32. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2018)

Performanca e sektorit mikrofinanciar

Dinamikat pozitive në sektorin mikrofinanciar mundësuan që performanca financiare pozitive të vazhdojë edhe gjatë TM1 2018. Profiti i sektorit arriti

në vlerë prej 2.4 milionë euro kundrejt TM1 2017 kur realizoi një profit prej 1.8 milionë euro (figura 33).

Figura 33. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2018)

Rritja e profitit kryesisht i atribuohet rritjes së theksuar të hyrave prej 1.9 milionë euro, vlera e të cilave arriti në 9.2 milionë euro, më konkretisht të hyrave nga interesi prej 2.2 milionë euro, të cilat edhe përfaqësojnë rreth 88 përqind të gjithsej të hyrave. Rritja e të hyrave nga interesi ishte rezultat i rritjes së aktivitetit kreditues nga institucionet mikrofinanciare në tre vitet e fundit, e po ashtu rezultat i rritjes së normës së interesit të aplikuar për kredi. Gjithsej shpenzimet e sektorit po ashtu shënuan rritje prej 1.2 milionë euro dhe arritën në 6.8 milionë euro, prej të cilave rritjen më të madhe e patën shpenzimet nga jo-interesi e veçanërisht shpenzimet e personelit dhe ato administrative.

Si rezultat i performancës pozitive financiare gjatë tremujorit të parë, treguesit e profitabilitetit të kalkuluar për gjithë vitin shënuan përmirësim (figura 34).


Figura 34. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



*Profiti është analizuar për tremujorin përkatës
Burimi: BQK (2018)

Institucionet mikrofinanciare vazhdojnë të karakterizohen me nivel të ulët të kredive me probleme dhe mbulueshmëri të mirë me provizione.

Figura 35. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore




Burimi: BQK (2018)

Niveli i kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë deri në mars 2018 u zvogëlua për 0.4 pikë përqindje kundrejt vitit paraprak duke rënë në 2.5 përqind (figura 35). Kurse, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në mars 2018 arriti në 210.2 përqind krahasuar me nivelin prej 208.9 përqind në mars 2017.

Tregu i letrave me vlerë

Në TM1 2018, Departamenti i Thesarit i Ministrisë së Financave të Qeverisë së Kosovës realizoi 4 ankande, në të cilat u emetuan bono dhe fletë-obligacione qeveritare në vlerë prej 104.95 milionë euro (figura 36).


Figura 36. Shuma e borxhit të emetuar, rritja vjetore



Burimi: Ministria e Financave

Vlera e emetuar e letrave me vlerë në këtë tremujor ishte për 35.5 përqind më e lartë se në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar dhe për 3.3 përqind më e lartë se në tremujorin paraprak.

Figura 37. Shuma e kërkuar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave (2018)

Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, numri i ankandeve të realizuara ishte i njëjtë, por

kemi zvogëlim të numrit të bonove të thesarit të emetuara dhe rritje të numrit të fletë-obligacioneve qeveritare (tabela 2).


Tabela 1. Numri dhe shuma e letrave me vlerë të arkëtuara nga Qeveria e Kosovës

Periudha	Bonot e thesarit		Fletë-obligacionet	
	Numri i realizuar	Vlera e pranuar	Numri i realizuar	Vlera e pranuar
Janar-Mars 2015	4	80.00	1	20.00
Janar-Mars 2016	3	60.00	3	60.00
Janar-Mars 2017	3	60.00	1	20.00
Janar-Mars 2018	2	60.00	2	48.40

Burimi: Ministria e Financave (2018)

Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë në TM1 2018 ka shënuar rritje (0.74 përqind) krahasuar me TM1 2017 (0.31 përqind). Kjo rritje mund të jetë ndikuar nga emetimi i numrit më të lartë të fletë-obligacioneve në këtë tremujor krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Po ashtu, rritja e normës mestarë të interesit mund të jetë ndikuar edhe nga oferta/kërkesa në letrat me vlerë. Shuma e kërkuar nga pjesëmarrësit ishte për 1.3 herë më e lartë se shuma e emetuar në ankande nga Ministria e Financave (2.3 herë më e lartë në TM1 2018).

Figura 38. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave (2018)

Struktura e letrave me vlerë sipas afatit të maturimit dominohet nga bonot e thesarit me afat maturimi 364

ditë, pasuar nga fletë-obligacionet qeveritare me afat maturimi 2 vite dhe ato me afat maturimi 5 vite.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, nuk kemi të emetuara bono me afat maturimi deri në 91 ditë përkatësisht 182 ditë.

Në vitet e fundit, struktura e letrave me vlerë është orientuar drejt afateve më të gjata të maturimit, kurse emetimet e bonove të thesarit, sidomos atyre me afat të shkurtër të maturimit kanë frekuencë shumë më të ulët të emetimit (figura 38).

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2018): Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar Nr. 22, TM1 2018, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2018):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>

ASK (2018):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit
- c) Indeksi i çmimeve të importit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>
- f) Buletini Tremujor, TM4 2017: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/buletini-tremujor-tm4-2017>
- g)

Të tjera (2018):

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,46>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://www.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës; Raporte tremujore: <http://www.trusti.org/sq/per-ne/raporte/835-2/>

Bloomberg (2018): Metal Prices database.

FAOUN (2018): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2018): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2018): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	TM1 2017	TM1 2018
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	1,247.5	-
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	1.6%	0.0%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	1.5%	0.1%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	339.3	362.0
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	333.4	400.7
Bilanci primar (në milionë euro)	5.9	-38.6
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,508.8	5,906.3
prej të cilave: Bankat	3,669.8	3,872.9
Kredi	2,294.9	2,534.3
Depozita	2,911.6	3,074.0
Norma e interesit në kredi, fundi i periudhës	7.0%	6.8%
Norma e interesit në depozita, fundi i periudhës	0.9%	1.2%
Hendeku i normës së interesit	6.1%	5.6%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-172.2	-165.1
prej të cilave: remitencat e pranuar	163.4	170.4
Llogaria financiare	-103.1	-61.6
Investimet e huaj direkte në Kosovë	65.1	64.4
Investimet portfolio, net	-26.1	-21.8
Investimet tjera, net	-94.8	-144.4
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-81.0	-120.1
Asetet	4,547.7	4,824.4
Detyrimet	4,628.7	4,944.4
Borxhi i jashtëm, gjithsej	2,015.1	2,091.6
Borxhi i jashtëm privat	1,570.5	1,598.3
Borxhi i jashtëm publik	444.6	493.3

Burimi:

1/ ASK (2018).

2/ MF (2018).

3/ BQK (2018).

*Të dhënat për PNI dhe borxh të jashtëm janë të fund vitit 2017 përkatësisht 2016.

